

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7891
E mërkurë, 25 shtator 2024
Çmimi 0.50

**IKD: KPK-ja të garantojë
transparencë
në draftregulloren
për kryeprokurorë** | FAQE 6



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

NË NJËVJETORIN E SULMIT NË BANJSKË NDEROHET HEROI AFRIM BUNJAKU

RRUGA BALLABAN - BANJSKË MERR EMRIN E HEROIT AFRIM BUNJAKU

 | FAQE 4-5

OPINION

**MUNDËSITË E INTEGRIMIT TË
REPUBLICËS SË KOSOVËS NË
STRUKTURAT NDËRKOMBËTARE**

F. 7

Shkruan:
Prof. dr. Fejzulla
BERISHA



AKTUALE



**GUTERRES: SITUATA GLOBALE ËSHTË
E PAQËNDRUESHME** F. 2

**SHBA-ja DHE BE-ja NË
NJËVJETORIN E BANJSKËS:
PËRGJEGJËSIT TË JAPIN LLOGARI** F. 5

EKONOMI



**IMPORTI NË KOSOVË ARRIN
SHIFRA REKORDE, PRIJNË MALLRAT
NGA TURQIA DHE KINA** F. 8

**KOSOVA MERR PJESË NË FORUMIN
EKONOMIK TË BALLKANIT
PERËNDIMOR NË BERLIN** F. 8

SPORT



**PAS NJË SUPERKARRIERE 22-VJEÇARE
PENSIONOHET ENIS ZABERGJA** F. 10



Udhëheqësit e Kosovës dhe ambasadorë të huaj në vend e kanë shënuar të martën njëvjetorin e sulmit të armatosur kundër Policisë së Kosovës në fshatin Banjskë në veri të vendit, duke e nderuar sakrificën e rreshterit të vrarë

Afrim Bunjaku. Në fshatin Banjskë të Zveçanit, në nderim të tij, u zbulua tabela e rrugës që do ta mbajë emrin "Afrim Bunjaku". Në përvjetorin e kësaj rruge morën pjesë kryeministri Albin Kurti dhe ministrat e tij



**ARMATIME DHE
KONFISKIME,
HISTORIKU I AKSIONEVE
POLICORE NË VERI
TË KOSOVËS** F. 3



**KOSOVA NËNSHKRUAN
TRI MARRËVESHJE
TË RËNDËSISHME
ME SUE DINË PËR
EKSTRADIM DHE
NDIHMË JURIDIKE** F. 7

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji
BIZNESI**

www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Guterres: Situata globale është e paqëndrueshme

NJU-JORK, 24 SHTATOR - Sekretari i përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, Antonio Guterres, paralajmëroi udhëheqësit botërorë, se mosndëshkimi, pabarazia, paqartësia po krijojnë një "botë të paqëndrueshme", pasi një numër në rritje i shteteve besojnë se mund të kalojnë pa u ndëshkuar. "Nuk mund të vazhdojmë kështu", tha ai gjatë debatit vjetor të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së ku po marrin pjesë presidentë, kryeministra, monarkë dhe udhëheqës të tjerë.

Duke përmendur thellimin e ndarjeve gjeopolitike, luftërat, ndryshimet klimatike e armët bërthamore, ai tha se njerëzimi "po shkon drejt të paimagjinueshmes - një fuçi baruti që rrezikon ta përfshijë botën". Por, tha ai, "sfidat që ne përballemi mund të zgjidhen" nëse komuniteti



ndërkombëtar përballet me reziqet e paqëndrueshmërisë, pabarazisë, padrejtësisë dhe mosndëshkimit, që tha se minojnë

ligjin ndërkombëtar dhe parimet themeltare të OKB-së.

Nisja e takimeve të udhëheqësve botërorë në OKB po ndodh në

kohën kur në botë janë rritur ndarjet, po zhvillohen luftëra në Gazë, Ukrainë dhe Sudan, dhe ka rrezik edhe për një konflikt më të

gjerë në Lindjen e Mesme.

Në fjalim, ai paralajmëroi se Libani, ku Izraeli ditët e fundit ka kryer sulme vdekjeprurëse ajrore, nuk duhet "të shndërrohet në një Gazë të re".

Ndërkaq, Guterres gjatë një fjalimi në "Samitin e të ardhmes" të mbajtur të dielën, tha se konfliktet në Lindjen e Mesme, Ukrainë dhe Sudan, por edhe sistemi i sigurisë globale po "kërcënohen nga ndarjet gjeopolitike dhe zhvillimet e armëve të reja".

Në punimet vjetore të OKB-së merr pjesë edhe presidenti amerikan Joe Biden që, me gjasë, do të jetë pjesëmarrja e madhe e tij e fundit në skenën botërore.

Ambasadorja amerikane në OKB, Linda Thomas-Greenfield, u tha gazetarëve javën e kaluar, se në punimet e OKB-së, ShBA-ja do të fokusohet në dhënien fund të luftërave në botë.

Scholzi thotë se Gjermania s'do t'i japë leje Ukrainës për armët me rreze të gjatë

Berlin, 24 shtator - Kancelari i Gjermanisë, Olaf Scholz, ka ngulur këmbë se vendi i tij nuk do t'i heqë kufizimet ndaj Ukrainës në lidhje me përdorimin e armëve gjermane me rreze të gjatë veprimi kundër Rusisë pavarësisht prej lutjeve të Kievit.

Qeveria i ka marrë "disa vendime" në lidhje me mbështetjen ushtarake për Ukrainën, të cilat "janë shumë të qarta për mua", tha Scholz në Nju-Jork. Atje Scholz pritet të takohet me presidentin ukrainas Volodymyr Zelensky.

Scholzi theksoi se në mesin e atyre vendimeve janë edhe kufizimet që ia ndalojnë Ukrainës të hedhë raketa gjermane thellë brenda territorit të Rusisë. "Kjo nuk është në përputhje me qëndrimin tim personal... Ne nuk do ta bëjmë këtë dhe kemi arsye të mirë për këtë", shtoi Scholz, i cili ndodhet në Shtetet e Bashkuara për të marrë pjesë në Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të

Bashkuara.

Zelensky u është lutur vazhdimisht partnerëve perëndimorë ta lejojnë Ukrainën t'i përdorë raketat e tyre me rreze të gjatë veprimi për t'i goditur shënjestrat thellë brenda tokës ruse, përfshirë fushat ajrore dhe depot e naftës të përdorura nga ushtria.

Arma me rreze më të gjatë veprimi që Gjermania ia ka dhuruar deri tani Kievit është raketahedhësi MARS II, i cili mund ta godasë shënjestrën 84 kilometra larg.

Berlini i ka dhënë leje Kievit ta përdorë këtë raketahedhës vetëm në hapësirë të kufizuar brenda tokës ruse, në afërsi të qytetit kufitar ukrainas Harkiv.

Scholzi nuk ka pranuar ta furnizojë Kievin me armë precize me rreze të gjatë veprimi pavarësisht prej vendimeve të aleatëve të Gjermanisë në NATO.

Gjermania nuk dëshiron t'i japë Ukrainës raketa lundruese Taurus të cilat mund të godasin caqe rreth



500 kilometra larg, duke argumentuar se "kjo do ta rriste dukshëm rrezikun për përshkallëzimin e luftës".

ShBA-ja, Britania e Madhe dhe Franca e kanë furnizuar Kievin me

raketa lundruese të cilat mund ta godasin shënjestrën deri në 300 kilometra larg. Ato janë duke shqyrtuar vendimin se a ta lejojnë apo jo Kievin t'i përdorë këto raketa për sulme ndaj shënjestrave thellë

brenda Rusisë.

Presidenti i Rusisë, Vladimir Putin, ka thënë se përdorimi i armëve të tilla nga Kiev do ta zhyste NATO-n në konflikt të drejtpërdrejtë me Rusinë.

Sulmet ajrore izraelite vrasin 558 njerëz në Liban



BEJRUTI, 24 SHTATOR - Së paku 558 njerëz janë vrarë si pasojë e bombardimeve të ashpra izraelite ndaj shënjestrave të Hezbollahit në Liban, tha Ministria e Shëndetësisë e Libanit të martën. Ushtria izraelite kreu të hënën sulme intensive ndaj Hezbollahit - grupit militant të shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara. E hëna ishte dita më vdekjeprurëse e konfliktit atje në 20 vjetët e fundit. Mijëra familje kanë ikur nga shtëpitë e tyre.

Ushtria Izraelite tha se i goditi 1 600 shënjestra të Hezbollahit në përpjekje për ta shkatërruar infrastrukturën që ky grup i armatosur e kishte ndërtuar pas luftës së vitit 2006.

Hezbollahu, ndërkohë, i shkrepiti mbi 200 raketa në veri të Izraelit, sipas ushtrisë. U raportua për dy njerëz të plagosur atje.

Fuqitë botërore kanë bërë thirrje për vetëpërmbytje, pasi të dyja palët duket se po shkojnë drejt një luftë të përgjithshme.

Ministria e Shëndetësisë e

Libanit tha se 50 fëmijë dhe 94 gra janë në mesin e të vrarëve, derisa 1 835 njerëz të tjerë janë plagosur.

Ajo nuk tregoi se sa prej të vrarëve ishin civilë apo luftëtarë.

Kryeministri i Izraelit, Benjamin Netanyahu, iu drejtua popullit libanez përmes një videoje. "Lufta e Izraelit nuk është kundër juve. Është kundër Hezbollahit. Hezbollahu ka kohë të gjatë që është duke ju përdorur si mburojë njerëzore", u tha Netanyahu libanezëve.

NË NJËVJETORIN E SULMIT NË BANJSKË NDEROHET HEROI AFRIM BUNJAKU

Rruga Ballaban - Banjskë merr emrin e heroit Afrim Bunjaku



Udhëheqësit e Kosovës dhe ambasadorë të huaj në vend e kanë shënuar të martën njëvjetorin e sulmit të armatosur kundër Policisë së Kosovës në fshatin Banjskë në veri të vendit, duke e nderuar sakrificën e rreshterit të vranë Afrim Bunjaku. Në fshatin Banjskë të Zveçanit, në nderim të tij, u zbulua tabela e rrugës që do ta mbajë emrin “Afrim Bunjaku”. Në përrurimin e kësaj rruge morën pjesë kryeministri Albin Kurti dhe ministrat e tij

lartë të policëve dhe me rritjen e moralit të policisë dhe ushtrisë sonë, Kosova nuk ka burime të brendshme që e cenonë sigurinë apo stabilitetin e të cilat ne nuk arrijmë t'i kontrollojmë apo menaxhojmë. “Numri i policëve me kadetë të rinj po rritet, morali i policisë sonë, edhe i ushtrisë sonë, kurrë s'ka qenë më i lartë. Andaj, kjo sakrificë, ky flijim i rreshterit të policisë, heroit të Kosovës, Afrim Bunjaku, ia ka vlejtur fort për policinë, për shtetin dhe për gjeneratat e ardhshme”, deklaroi ai.

Së bashku në këtë vizitë të familjarët e të ndjerit ishin edhe ministri i Punëve të Brendshme i Kosovës, Xhelal Sveçla dhe drejtori i Policisë së Kosovës, Gazmend Hoxha. Ata vazhduan drejt varrezave të fshatit, të shoqëruar nga familjarë, ministra, deputetë, ambasadorë dhe policë, në nderim të jetës dhe kontributit të heroit Afrim Bunjaku.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, shkroi në rrjetet sociale se “Kosova është dhe do të mbetet e pandashme, e liria dhe kufijtë tanë të paprekshëm”. “Sot një vit rreshteri Afrim Bunjaku ra dëshmor, për të treguar edhe një herë, siç kemi dëshmuar ndër shekuj, se kjo tokë është atdheu ynë i përjetshëm”, shkroi Osmani në “Facebook”, e cila ndodhet në Shtetet e Bashkuara për një vizitë.

Rruga që çon te Banjska merr emrin e heroit Afrim Bunjaku

Pas vizitës te familja e heroit Afrim Bunjaku, në njëvjetorin e rënies së tij dhe homazheve të varri i të ndjerit, kryeministri Kurti së bashku me kryetarin e Kuvendit, Glauk Konjufca, ministrin e Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ministrin e Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, ministrin e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, drejtorin e Policisë së Kosovës, Gazmend Hoxha, vizituan vendin e rënies së rreshterit Bunjaku, përkatësisht në fshatin Banjskë të Zveçanit, ku në nderim të tij u zbulua tabela e rrugës që do ta mbajë emrin “Afrim Bunjaku” sipas vendimit të mbledhjes së 221-të të qeverisë.

Në deklarin e tij para medieve, kryeministri Kurti potencoi se Banjska e 24 shtatorit 2023 ka qenë një plan për ta sulmuar Kosovën ka qenë një agresion kundër sovranitetit shtetëror, integritetit territorial, paqes, sigurisë, kushtetutshmërisë, dhe ligjshmërisë. “Plani ishte që të ndahet Kosova. Plani ishte që të aneksohet një pjesë e territorit dhe rënia e Afrim Bunjakut nuk ishte e kotë, përkundrazi ajo është fitore e madhe e shtetit të Kosovës për të gjithë qytetarët pa dallim dhe në mbrojtje të tërësisë tonë territoriale. Kosova është një dhe e pandashme”, deklaroi

kryeministri.

Gjatë vizitës në vendin e rënies së heroit Afrim Bunjaku, kryeministri Kurti ishte bashkë me policët që para një viti në orët e hershme të mëngjesit të 24 shtatorit 2023 u ballafaquan me paramilitarët e Radoiçiqit, të cilët ndanë detaje nga ballafaqimi me sulmin.

Kurti shprehu mirënjohjen e tij të thellë dhe falënderime të përjetshme ndaj policisë sonë për të gjithë punën, angazhimin dhe kontributin në sigurinë e vendit.

Në fillim të këtij muaji, Prokuroria Speciale e Kosovës ngriti aktakuzë kundër 45 personave për këtë sulm.

Ambasadori amerikan në Prishtinë, Jeffrey Hovenier, bëri homazhe te varri i Bunjakut në Vushtrri. “Sot iu bashkova Qeverisë së Kosovës dhe kolegëve të mi diplomatikë për ta nderuar kujtimin e oficerit të Policisë së Kosovës, Afrim Bunjaku, i cili u vra në detyrë në sulmin e Banjskës, një vit më parë. Shtetet e Bashkuara përsërisin thirrjet dhe presin që kryerësit dhe të gjithë të përfshirët në këtë krim të tmerrshëm të mbahen përgjegjës”, shkroi Hovenier në rrjetet sociale.

Përgjegjësinë për sulmin e mori Millan Radoiçiq, ish-nënkryetar i Listës Serbe, partisë më të madhe të serbëve në Kosovë, e cila mbështetet nga Beogradi.

Në aktakuzën e ngritur nga Prokuroria e Kosovës, Radoiçiqi cilësohet si “kreu i grupit terrorist”.

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

VUSHTRRI, 24 SHTATOR - Udhëheqësit e Kosovës dhe ambasadorë të huaj në vend e kanë shënuar të martën njëvjetorin e sulmit të armatosur kundër Policisë së Kosovës në fshatin Banjskë në veri të vendit, duke e nderuar sakrificën e rreshterit të vranë Afrim Bunjaku.

Më 24 shtator të vitit të kaluar, një grup i serbëve të armatosur sulmoi Policinë e Kosovës në fshatin e Zveçanit, duke e vranë rreshterin Afrim Bunjaku. Gjatë përlëshjeve që pasuan u vranë edhe tre sulmues serbë. Me këtë rast, kryeministri Albin Kurti, i shoqëruar nga kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, vizituan familjen e heroit të Kosovës, Afrim Bunjaku, pastaj bënë homazhe te varri i tij.

Në shënim të kësaj date të rëndësishme në historinë e Kosovës, kryeministri Kurti rikujtoi rënien heroike të

rreshterit Afrim Bunjakut, e cila, sipas tij, është dëshmi që Kosova edhe i del zot vetes edhe ngadhënjën në çdo betejë. “Në orët e hershme të mëngjesit të 24 shtatorit, para një viti, rreshteri i Policisë së Kosovës, Afrim Bunjaku, ra heroikisht në mbrojtje të kushtetutshmërisë e të ligjshmërisë, në mbrojtje të sovranitetit shtetëror dhe të integritetit territorial, në mbrojtje të rendit publik, të paqes e të sigurisë dhe kësajsoj lartësoi shtetin e Kosovës edhe për popullin e Kosovës, por edhe për opinionin publik ndërkombëtar”, tha kryeministri Kurti, duke shtuar se dëshmorët janë dëshmi e orëve të historisë.

Ai ritheksoi faktin që Serbia është përgjegjëse, andaj duhet të japë përgjegjësi, “derisa në këtë pikë ne kërkojmë mbështetjen, ndihmën, përkrahjen e faktorëve ndërkombëtarë”.

Më tutje, kryeministri Kurti shprehu se sot me numrin e





Armatime dhe konfiskime, historiku i aksioneve policore në veri të Kosovës

Aksionet në zonat e banuara me shumicë serbe janë bërë më të shpeshta pas 24 shtatorit të 2023-s, kur një grup i armatosur serbësh sulmoi policinë e Kosovës në Banjskë të Zveçanit

PRISHTINË, 24 SHTATOR - Më pak se tre vjet pas fundit të luftës në Kosovë, ushtarë të Misionit të NATO-s në vend (KFOR) dhe pjesëtarë të policisë së Kombeve të Bashkuara kanë konfiskuar një sasi armatimi në veriun e banuar me shumicë serbe. Njëqind pushkë, 15 pistoleta, 40 granata, si dhe sasi e madhe eksplozivi dhe municioni...

Lista të ngjashme armatimi, si që është konfiskuar në shkurt të vitit 2002, janë publikuar disa herë ndër vite, pas aksioneve të ndryshme në atë zonë të Kosovës. KFOR-i, Misioni i BE-së për Sundim të Ligjit (EULEX) dhe së fundi Policia e Kosovës kanë njoftuar për aksione të tilla. Një pyetje drejtuar autoriteteve në Kosovë, pas këtij sulmi, ka mbetur

pa përgjigje konkrete: Si po hyn ky armatim brenda territorit të Kosovës?

Dogana e Kosovës ka thënë se armatimi ka hyrë përmes "rrugëve malore", por nuk ka dhënë më shumë hollësi. Ndërsa drejtori i Policisë së Kosovës, Gazmend Hoxha, ka thënë se është e pamundur që të kontrollohet vija kufitare me Serbinë "çdo minutë e çdo sekondë".

Kosova dhe Serbia ndajnë një vijë kufitare prej rreth 400 kilometrash. Mbi 60 për qind e asaj përfshin komunat e banuara

me shumicë serbe në veri të Kosovës.

21 shkurt 2023, konfiskohen 6 300 municione në veri

Njësitë i Ndërhyrjes së Shpejtë në kufirin në Joshanicë, në veri të Kosovës, kontrollon një veturë me targa të Serbisë të një shtetasi serb dhe gjen municion. Ministri i Punëve të Brendshme i Kosovës, Xhelal Sveçla, thotë se gjatë aksionit u konfiskuan 6 300 municione të kontrabanduara nga Serbia.

23 qershor 2023, armatim në Zveçan

Një veturë me targa të Beogradit, rreth 100 metra larg komunës së Zveçanit. Policia e Kosovës gjen aty sasi të madhe të armatimit, përfshirë mjete shpërthyes, municione, granatahedhës dore, armë automatike e shok-bomba. Ministri Sveçla thotë se, gjatë javëve paraprake, nga Serbia në Kosovë ishin futur vetura me armatime ushtarake. Sipas drejtorit të Policisë së Kosovës, Gazmend Hoxha, shumica e armatimeve janë



ShBA-ja dhe BE-ja në njëvjetorin e Banjskës: Përgjegjësit të japin llogari

PRISHTINË, 24 SHTATOR - Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian kanë kërkuar që të gjithë të përfshirët në sulmin e armatosur ndaj Policisë së Kosovës në Banjskë të Zveçanit një vit më parë të mbahen përgjegjës.

Më 24 shtator të vitit të kaluar, një grup i serbëve të armatosur sulmoi Policinë e Kosovës në fshatin Banjskë të Zveçanit, duke e vrarë rreshterin Afrim Bunjaku. Gjatë përleshjeve që pasuan u vrarë edhe tre sulmues serbë.

Ambasadori amerikan në Prishtinë, Jeffrey Hovenier, bëri homazhe te varri i Bunjakut në Vushtrri më 24 shtator. "Sot iu bashkova Qeverisë së Kosovës dhe kolegëve të mi diplomatikë për ta nderuar kujtimin e oficerit të Policisë së Kosovës, Afrim Bunjaku, i cili u vra në detyrë në sulmin e Banjskës, një vit më parë. Shtetet e Bashkuara përsërisin thirrjet dhe presin që kryerësit dhe të gjithë të përfshirët në këtë krim të tmerrshëm të mbahen përgjegjës", shkroi Hovenier në X.

Ndërkaq BE-ja tha se pret nga Serbia të ndërmarrë hapa të nevojshëm për t'u siguruar që të dyshuarit për kryerjen e sulmit vdekjeprurës në Banjskë të japin



llogari.

Kosova e ka cilësuar sulmin si terrorist dhe e akuzon shtetin e Serbisë se ka gisht në të. Serbia i ka mohuar akuzat.

Në fillim të këtij muaji, Prokuroria Speciale e Kosovës ngriti aktakuzë kundër 45 personave për këtë sulm. Përgjegjësinë për sulmin e mori Millan Radoiçiq, ish-nënkryetar i Listës Serbe, partisë më të madhe të

serbëve në Kosovë, e cila gëzon mbështetjen e Beogradit.

Në aktakuzën e ngritur nga Prokuroria e Kosovës, Radoiçiqi cilësohet si "kreu i grupit terrorist".

I pyetur nga Radio Evropa e Lirë se a duhet Serbia të bashkëpunojë me Kosovën në proceset gjyqësore që do ta pasojnë, Stano tha: "Po, kjo është ajo që ne kemi nënvizuar në mënyrë të vazhdueshme, për ato

raste ku kryesit e dyshuar janë në Kosovë".

Autoritetet në Serbi refuzojnë ta ekstradojnë Radoiçiqin në Kosovë dhe thonë se ai do të gjykohej nga "gjykatat serbe", ndërsa zyrtarët në Kosovë thonë se ato i kanë ofruar mbrojtje atij.

Stano tha, gjithashtu, se Serbia duhet të bëjë më shumë edhe në lidhje me të dyshuarit për sulme

ndaj ushtarëve të KFOR-it, ndaj medieve dhe qytetarëve në trazirat e muajit maj të vitit të kaluar. "BE-ja, në mënyrë të përsëritur, ka shprehur pritjet që Serbia duhet të bashkëpunojë plotësisht dhe t'i ndërmarrë të gjitha masat e domosdoshme për të kapur dhe për t'i sjellë shpejt para drejtësisë kryesit e akteve të dhunës nga ana e protestuesve serbë të Kosovës ndaj qytetarëve, pjesëtarëve të KFOR-it, organeve të rendit dhe mediave, më 29 maj të vitit 2023. Gjithashtu, edhe për sulmet e dhunshme më 24 shtator 2023 në veri të Kosovës", tha ai.

Qershorin e kaluar gazetarë të medimeve të ndryshme u sulmuan fizikisht teksa po raportonin nga komuna e Leposaviqit, një prej katër komunave në veri, të banuara me shumicë serbe, sipas Policisë së Kosovës.

Tensionet në veri të Kosovës u rritën më 26 maj, kur kryetarët e rinj shqiptarë të komunave në veri, me asistimin e Policisë së Kosovës, u vendosën në ndërtesat komunale. Tensionet kulmuan më 29 maj, kur protestuesit serbë u përleshën me pjesëtarët e KFOR-it në Zveçan, me ç'rast u lënduan rreth 100 ushtarë të misionit paqeruajtës.

Komisioni për Punë të Jashtme u jep mbështetje tri projektligjeve

PRISHTINË, 24 SHTATOR - Komisioni për Punë të Jashtme dhe Diasporë ka mbajtur të martën mbledhjen e radhës, kryesuar nga Arbëreshë Kryeziu-Hyseni, kryetare e këtij komisioni. Me këtë rast, Komisioni shqyrtoi dhe përkrahu raportin e punës së këtij komisioni për sesionin pranveror të vitit 2024 si dhe Draft-planin e punës së komisionit për sesionin

vjeshtor për këtë vit.

Në vijim të takimit, komisioni shqyrtoi dhe iu dha mbështetje edhe tri projektligjeve: Projektligjit nr. 08/L-317 për aderim në "Konventën për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja në çështje civile apo tregtare", Projektligjit nr. 08/L-318 për aderim në "Konventën për marrjen e provave jashtë vendit në çështjet civile apo tregtare", si

dhe Projektligjit nr. 08/L-319 për aderim në "Konventën për gjedhjen e marrëveshjeve gjyqësore".

Lidhur me qëllimin dhe fushën që rregullojnë këto projektligje, foli kryetarja e komisionit, Arbëreshë Kryeziu-Hyseni. Mes të tjerash, ajo bëri me dije se projektligjet përmbajnë nga tri nene dhe do t'i nënshtrohen vetëm një shqyrtimi në seancë plenare.



prodhim i Serbisë. Pesëmbëdhjetë nga 21 granatat e konfiskuara ishin prodhim i vitit 2021.

14 gusht 2023, konfiskohen 1.200 fishekë në Rudinë të Zveçanit

Gjatë një aksioni policor në fshatin Rudinë të Zveçanit konfiskohen 1.200 fishekë nga Njësia e Policisë së Kosovës për Ndërhyrje të Shpejtë.

5 shtator 2023, Sveçla: Veriu hap pas hapi po shkon drejt normalitetit

Ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, bën me dije se janë zhvilluar bastisje në Zveçan, ku është gjetur sasi e madhe e armatimit, përfshirë armë automatike, fishekë, granata dore dhe eksplozivë. Ai shkroi në "Facebook" se "veriu po shkon hap pas hapi drejt normalitetit", pas aksionit të përbashkët të Policisë së Kosovës dhe Misionit të NATO-s në Kosovë, KFOR.

24 shtator 2023, sulmi në Banjskë

Rreshteri Afrim Bunjaku vritet gjatë një sulmi ndaj Policisë së Kosovës nga një grup i armatosur serbësh në Banjskë të Zveçanit. Sipas aktakuzës së ngritur më 11 shtator, kreu i këtij grupi ka qenë ish-nënkryetari i Listës Serbe, Millan Radoiçiq, i cili e ka marrë përgjegjësinë për sulmin.

25 shtator 2023, policia konfiskon armatim të rëndë

Pas sulmit në Banjskë, Policia e Kosovës nisi operacionet në zonën përreth. Si rezultat, u konfiskua një sasi e madhe e armatimit. Aty u gjetën armë të kalibrit të lartë gulinov, mitralozë, snajperë, minahedhës, armë të gjata, granata dore etj.

14 tetor 2023, bastisje në shtatë lokacione

Granatahedhës dore, eksplozivë, mina kundër këmbësorisë, mina me sahat e teledirigjim,

detonatorë... Ministri i Brendshëm, Xhelal Sveçla, njofton se Policia e Kosovës ka bastisur shtatë lokacione në veriun e banuar me shumicë serbe. Sipas tij, armatimi i gjetur në ato lokacione ishte i prodhimit të njëjtë me armët e konfiskuara në Banjskë.

25 dhjetor 2023, konfiskohet municion në veri

Policia e Kosovës bën me dije se ka konfiskuar një numër të "pajisjeve të rezikshme" në lagjen multietnike në Mitrovicën e Veriut, për të cilat tha se rrezikonin që potencialisht të përdroreshin për sulm ndaj zyrtarëve policorë. Përveç telave gjemborë dhe bombave tymosëse, gjatë aksionit u konfiskua edhe armatim.

14 maj 2024, sërish konfiskohet armatim në Zveçan

Policia e Kosovës njofton se ka konfiskuar sasi të konsiderueshme të armatimit: 1.500 municione, dhjetë armë të gjata, 62 shok-bomba, eksplozivë e uniforma të ushtrisë serbe. Armët janë gjetur në afërsi të një ish-zyrtari të Policisë së

Kosovës në veri, i cili pastaj është arrestuar. Ministri Sveçla thotë se kjo është depoja e pestë e armatimit e zbuluar gjatë këtij viti në veriun e Kosovës. Sipas tij, ato armë janë "mbetje e armatimit të grupeve terroriste të udhëhequra nga Millan Radoiçiq, e të financuara, dirigjuara dhe mbështetura nga presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq".

27 maj 2024, REL-i identifikon armët e gjetura

Njësia e Forenzikës Digjitale e Radios Evropa e Lirë arrin t'i identifikojë llojet dhe prodhimin e disa prej armëve e municionit të gjetur, në bazë të detajeve nga fotografitë e publikuara. Plumbat e ekspozuar në objektin e Drejtorisë Rajonale Policore - Mitrovicë Veri janë prodhuar në vitin 1991 në fabrikën "Prvi Partizan" në Uzhiçë të Serbisë, ndërsa baruti i tyre është prodhuar në vitin 1990 në fabrikën "Millan Blagojeviq" në Luçan të Serbisë. Ndërkohë, një tjetër lloj i plumbave të ekspozuar janë prodhuar edhe në fabrikën "Igman Zavod Kanjiq" në Bosnjë-

Hercegovinë në vitin 1988. Sa i përket armëve të gjata të konfiskuara, për atë lloj njihet kompania e armëve "Zastava" me lokacion në Kragujevc të Serbisë. E njëjta fabrikë ka prodhuar edhe një lloj të pushkës së konfiskuar.

14 qershor 2024, bastisen katër lokacione në veri dhe konfiskohet armatim

Katër lokacione, qindra armë dhe municione. Në një aksion tjetër policor në veri të Kosovës konfiskohen armë të gjata, fishekë, jelekë antiplumbë dhe shumë pajisje të tjera. Autoritetet thanë se armatimi ishte fshehur nga ish-pjesëtarët të Mbrojtjes Civile - grupit të shpallur organizatë terroriste nga Kosova - dhe pjesëtarët të grupit të armatosur, përgjegjës për sulmin në Banjskë. "Sërish armë, eksplozivë e municion i konfiskuar në veri të vendit falë vigjilencës së shtuar të institucioneve tona dhe vendosmërisë për asgjësimin e secilit element kriminal dhe tendencës destabilizuese që vjen nga Beogradi", shkroi Sveçla në "Facebook".

Mundësitë e integrimit të Republikës së Kosovës në strukturat ndërkombëtare



Shkruan:
Prof. dr. Fejzulla BERISHA

Për të përmirësuar perspektivat e integrimit të Republikës së Kosovës në organizatat ndërkombëtare, është thelbësore që qeveria të ndërmarrë një qasje të plotë dhe të mbështetur në fakte, duke përfshirë hapa strategjikë në disa fusha kyçe. Përmes një analize të thelluar, mund të identifikohen fushat prioritare dhe masat konkrete që duhet të ndërmerren për të avancuar në këtë drejtim. Integrimi ndërkombëtar i Kosovës nuk varet vetëm nga përbushja e kritereve teknike, por edhe nga faktorë politikë, diplomatikë dhe strategjikë.

Diplomacia aktive: Sigurimi i njohjeve ndërkombëtare. Kosova deri më sot është njohur nga më shumë se 100 shtete anëtare të Kombeve të Bashkuara, përfshirë shumicën e vendeve të BE-së dhe ShBA-në. Megjithatë, disa vende kyçe, përfshirë pesë anëtarë të BE-së (Spanja, Sllovakia, Qiproja, Greqia dhe Rumania), ende nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës. Për të përshpejtuar procesin e njohjeve, Kosova duhet të përqendrohet në përfundimin e diplomacisë bilaterale dhe multilaterale. Kjo përfshin zhvillimin e marrëdhënieve të qëndrueshme me vendet që nuk e kanë njohur ende pavarësinë e saj, si dhe sigurimin e mbështetjes nga organizata ndërkombëtare të rëndësishme si OKB, BE, OSBE dhe UNESCO etj.

Rasti i UNESCO-s dhe INTERPOL-it: Para disa viteve, Kosova u përpoq të bëhej anëtare e UNESCO-s, por nuk arriti të sigurojë votat e nevojshme. Pavarësisht kësaj, vazhdimi i përpjekjeve diplomatike në këto organizata do të ishte një hap strategjik për njohjen e mëtejshme të Kosovës dhe për përfshirjen në forumet ndërkombëtare që luajnë rol të rëndësishëm në politikën globale. Veçanërisht, anëtarësimi

në INTERPOL është një domosdoshmëri për bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e sigurisë.

Njohja nga shtetet anëtare të OKB-së: Për të siguruar njohjen nga vendet që ende nuk e kanë njohur, qeveria e Kosovës duhet të përqendrohet në forcimin e marrëdhënieve me shtete si India, Kina dhe Rusia. Këto vende, si anëtarë të përhershëm të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, kanë një ndikim të madh në pranimin e Kosovës në këtë organizatë.

Zbatimi i reformave demokratike dhe të shtetit të së drejtës: Një nga kërkesat kryesore të BE-së dhe institucioneve të tjera ndërkombëtare për anëtarësimin e vendeve të reja është përbushja e standardeve të shtetit të së drejtës, demokracisë dhe të drejtave të njeriut. Për Kosovën, kjo përfshin reformimin e sistemit gjyqësor, rritjen e transparencës dhe luftën kundër korrupsionit.

Lufta kundër korrupsionit: Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit (CPI) nga Transparency International e ka renditur Kosovën në pozicione relativisht të ulëta krahasuar me vendet e rajonit. Rritja e përpjekjeve për të luftuar korrupsionin dhe për të ndërtuar një sistem drejtësie të pavarur

është kyçe për përbushjen e kërkesave ndërkombëtare.

Transparenca dhe efikasiteti i institucioneve shtetërore: Qeveria e Kosovës ka ndërmarrë disa hapa për të rritur transparencën dhe përgjegjshmërinë e institucioneve, por ende mbetet punë për të bërë. Kjo përfshin përmirësimin e proceseve të prokurimit publik, si dhe rritjen e efikasitetit të sistemit të drejtësisë, për të ndërtuar besim në komunitetin ndërkombëtar dhe për të përbushur kërkesat e BE-së për sundimin e ligjit.

Angazhimi në dialogun me Serbinë: Normalizimi i marrëdhënieve. Një çështje e rëndësishme për integrimin ndërkombëtar të Kosovës është dialogu me Serbinë për normalizimin e marrëdhënieve. Ky proces, i ndërmjetësuar nga BE, është një kërkesë thelbësore për përfundimin e marrëdhënieve të BE dhe organizata të tjera ndërkombëtare.

Marrëveshjet e Brukselit: Kosova dhe Serbia kanë nënshkruar disa marrëveshje nën ndërmjetësimin e BE-së, përfshirë marrëveshjen e vitit 2013 për normalizimin e marrëdhënieve. Megjithatë, zbatimi i këtyre marrëveshjeve ka qenë i ngadaltë (deklarativ), dhe përfundimi i këtyre proces është një element kyç për

sigurimin e mbështetjes ndërkombëtare.

Rëndësia e normalizimit të marrëdhënieve për integrimin në BE: Normalizimi i marrëdhënieve me Serbinë është një nga kushtet kryesore që BE ka vendosur për anëtarësimin e Kosovës në këtë organizatë. Përfundimi i dialogut mund të shërbejë si një katalizator për integrimin në BE dhe për përmirësimin e marrëdhënieve ndërkombëtare në tërësi.

Rritja e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar: Një politikë e jashtme e orientuar nga rajoni dhe partnerët strategjikë. Kosova duhet të forcojë marrëdhëniet me vendet e Ballkanit Perëndimor dhe të marrë një rol më proaktiv në nismat rajonale. Përmes angazhimit në nisma si Procesi i Berlinit dhe Marrëveshja CEFTA, Kosova mund të përforcojë pozicionin e saj në rajon dhe të tregojë angazhimin për bashkëpunim dhe zhvillim ekonomik.

Procesi i Berlinit dhe CEFTA. Marrëveshjet si CEFTA ofrojnë mundësi për integrimin ekonomik të Kosovës në rajon dhe për rritjen e shkëmbimeve tregtare. Kosova duhet të vazhdojë të shfrytëzojë këto mundësi për të forcuar marrëdhëniet rajonale dhe për të

përmirësuar zhvillimin e saj ekonomik.

Aleatët strategjikë: Marrëdhëniet me ShBA-në dhe vendet kryesore të BE-së janë thelbësore për mbështetjen ndërkombëtare të Kosovës. ShBA-ja ka qenë mbështetësi kryesor i pavarësisë së Kosovës, dhe vazhdimi i bashkëpunimit me këtë aleat strategjik është thelbësor për avancimin në organizatat ndërkombëtare.

Rritja e kapaciteteve diplomatike dhe lobuese. Kosova duhet të rrisë kapacitetet e saj diplomatike dhe të investojë në ndërtimin e një rrjeti të fuqishëm lobimi në vendet kyçe. Rritja e përfaqësive diplomatike në vendet strategjike dhe krijimi i një rrjeti ndërkombëtar për lobim është një nga hapat më të rëndësishëm për të siguruar mbështetje për çështjet e Kosovës në arenën ndërkombëtare.

Promovimi i imazhit ndërkombëtar. Një element kritik për integrimin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare është imazhi që projekton në arenën globale. Një fushatë për promovimin e Kosovës si një shtet demokratik, multietnik dhe ekonomikisht të qëndrueshëm, do të përmirësojë perceptimin ndërkombëtar dhe do të rrisë mbështetjen për integrimin e saj.



Vazhdon punimet grupi punues për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Penal



Prishtinë, 24 shtator - Të martën kanë vazhduar punimet për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Penal të Republikës së Kosovës, me qëllim të qartësimit dhe përfshirjes së dispozitave të reja që reflektojnë konceptet bashkëkohore në fushën e së

drejtës penale. Këto ndryshime synojnë mbrojtjen, promovimin dhe përfundimin e vlerave të përcaktuara në legjislacionin tonë në fuqi, duke kontribuar në përmirësimin e sistemit të drejtësisë penale në vend.

Ky proces i rishikimit dhe modernizimit të Kodit Penal është një hap i rëndësishëm për përmirësimin e sigurisë dhe drejtësisë në Kosovë, duke garantuar mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore për të gjithë qytetarët.

IKD: KPK-ja të garantojë transparencë në draftrrregulloren për kryeprokurore

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 24 SHTATOR - Këshilli Prokurorial i Kosovës në mbledhjen e 253-të si pikë të rendit të ditës ka vendosur miratimin e rregullores për emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Kryeprokurore të Prokurorive të Republikës së Kosovës. Përkitazi me rregulloren në fjalë, Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka dërguar komente në KPK. Duke mirëpritur adresimin e një pjese të komenteve, IKD-ja gjënë se drafti i paraqitur për votim në KPK vazhdon të mos garantojë transparencë të duhur të procesit dhe krijon pabarazi mes anëtarëve të Këshillit, duke mos ndjekur standardet adekuate të miratuara nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës në raport me procesin e emërimit të kryetarëve të gjykatave.

Në komentet e dërguara, IKD-ja rekomandoi detajimin e obligimeve lidhur me transparencën, në mënyrë që proceset për kryeprokurore të jenë transparente para publikut,



kandidatëve për kryeprokurore dhe stafit të sistemit prokurorial. Një detajim të tillë nuk e përmban drafti që është dërguar për miratim në KPK, i cili përmban vetëm dispozita të përgjithshme në lidhje me transparencën.

Dispozita të tilla lënë hapësira të mëdha interpretimi dhe

arbitrariteti, të cilat më pastaj kthehen në mungesë transparence, problem ky i vazhdueshëm i këtyre proceseve të KPK-së.

Me qëllim të vlerësimit adekuat të kandidatëve, IKD-ja rekomandoi mundësinë e marrjes së mendimeve apo informatave me karakter këshillëdhënës nga secili

prokuror për secilin kandidat për kryeprokurore. Për dallim nga KGJK, KPK nuk e mori për bazë këtë koment. Sipas draftrrregullores së dërguar për miratim, kryesues i Panelit për Vlerësim do të jetë kryesuesi i KPK-së.

IKD-ja në komentet e dhëna ka rekomanduar që KPK ta

themelojë Panelin Vlerësues dhe me vendim ta caktojë edhe kryesuesin e këtij paneli, duke mos përcaktuar që automatikisht Kryesuesi i KPK-së të jetë edhe kryesuesi i Panelit për Vlerësim. Dhënia e një detyre të tillë paraqet trajtim të pabarabartë mes anëtarëve të KPK dhe kryesuesit të tij, i cili është "i pari në mesin e barabartëve". Edhe në këtë rast, KPK nuk mori për bazë rekomandimin e IKD dhe nuk ndoqi linjën e KGJK-së.

Në anën tjetër, në mbledhjen e sotshme në rend të ditës është edhe shqyrtimi i vendimit për pagën e anëtarëve joprokurorë të KPK-së. Lidhur me këtë vendim, IKD i rekomandon KPK-së të ketë një vëmendje të shtuar, duke respektuar dispozitat dhe parimet ligjore.

Vendimi i marrë nga KPK-ja në asnjë mënyrë nuk duhet të shërbejë si dekurajim për anëtarët joprokurorë të KPK-së. Ky fakt vetëm sa do ta përforconte nivelin e korporatizimit brenda KPK-së, pasi një qasje e tillë për anëtarët joprokurorë do të nënkuptohej potencialisht si përjashtuese.

Kosova nënshkruan tri marrëveshje të rëndësishme me Suedinë për ekstradim dhe ndihmë juridike



PRISHTINË, 24 SHTATOR - Ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka pritur të martën në takim sekretarin Shtetëror të Mbretërisë së Suedisë, Mikael Kullberg. Pas takimit ministrja Haxhiu dhe sekretari Kullberg kanë nënshkruar tri marrëveshje bashkëpunimi në fushën e bashkëpunimit juridik - ndërkombëtar në mes të Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Suedisë.

Republika e Kosovës është shteti i parë në Ballkan që lidh marrëveshje të tilla bashkëpunimi me Mbretërinë e Suedisë. Në fjalën e saj, ministrja Haxhiu tha se ky akt është edhe një hap tutje në avancimin dhe thellimin e partneritetit dhe bashkëpunimit në mes të Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Suedisë në fushën juridike ndërkombëtare. Marrëveshja e parë, përkatësisht ajo për Ndihmë Juridike të Ndërsjellë në Çështjet Penale, synon krijimin e një baze ligjore dypalëshe që do ta thellojë

bashkëpunimin dhe do t'i harmonizojë procedurat për ndihmë juridike mes dy vendeve, duke garantuar një bashkëpunim më efektiv.

Në anën tjetër, marrëveshja për ekstradim përmban rregullime të hollësishme për procedurat që do të ndiqen nga momenti i parashtrimit të kërkesës për ekstradim deri në dorëzimin e personit të ekstraduar, në përputhje me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe pasqyron praktikën më të mira evropiane për trajtimin e kërkesave për ekstradim.

Ndërsa marrëveshja për transferimin e personave të dënuar me Qeverinë e Mbretërisë së Suedisë, mes të tjerash, ka për qëllim përmirësimin e bashkëpunimit në fushën e drejtësisë dhe rehabilitimin social të personave të dënuar, duke lejuar transferimin e tyre për ekzekutimin e dënimeve në shtetin e vendbanimit të përhershëm.

Vazhdon periudha për aplikim të subjekteve politike për dorëzimin e listës së kandidatëve për deputetë

PRISHTINË, 24 SHTATOR - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve njofton se është duke vazhduar periudha për aplikim të subjekteve politike për certifikimin dhe dorëzimin e listës së kandidatëve për deputetë për Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, të cilat do

të mbahen më 9 shkurt 2025. Gjatë periudhës 102 ditore (1 shtator - 11 dhjetor 2024) kërkesat për certifikim nga subjektet politike duhet të dorëzohen në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, përkatësisht në Zyrën për Regjistrim, Certifikim dhe

Kontroll Financiar të Subjekteve Politike (ZRCKFSP). Gjithashtu, gjatë kësaj kohe subjektet politike (partitë politike, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur) duhet ta dorëzojnë listën e kandidatëve për deputetë.



Qeveria ndan 219 mijë euro për organizimin e Forumit Ekonomik në Paris



PRISHTINË, 24 SHTATOR - Qeveria e Republikës së Kosovës ka mbajtur mbledhje elektronike, në të cilën ka ndryshuar dhe plotësuar vendimin e Qeverisë nr. 06/56 të datës 26 janar 2022, i ndryshuar dhe plotësuar me vendimin e Qeverisë nr. 02/184 të datës 15 janar 2024. Sipas këtij plotësim-ndryshimi, Gëzim Paci bëhet kryesues i Bordit të Postës së Kosovës. Gjithashtu, Genc Metaj është emëruar në pozitën e drejtorit ekzekutiv në

Agjencinë për Menaxhimin e Emergjencave. Kabineti qeveritar ka emëruar Komisionin ad hoc për Vlerësimin Profesional për Pranim për Pozitën e Lartë të Kategorisë Drejtuese: Drejtor i Përgjithshëm në Institutin e Kosovës për Administratë Publike. Në këtë mbledhje janë ndarë 219 000.00 euro për organizimin e Forumit Ekonomik në Paris dhe promovimin e teknologjisë së

informacionit me qëllim të tërheqjes së investimeve në kuadër të kësaj fushe përmes organizatave lidere gjatë javës së TIK/ICT. Po ashtu, është aprovuar Rregullorja për Vlerësimin e Rezultateve në Punë; Rregullorja për Procedurat e Konkurrimit për Nëpunësit Teknikë dhe Mbështetës; Rregullorja për Pezullimin nga Marrëdhënia e Punës; dhe Rregullorja për Përfundimin e Marrëdhënies së Punës në Shërbimin Civil.

Importi në Kosovë arrin shifra rekorde, prijnë mallrat nga Turqi dhe Kina

PRISHTINË, 24 SHTATOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar të dhënat lidhur me rrjedhat e eksportit dhe importit për muajin gusht 2024. Deficiti tregtar ka arritur 9.4% në muajin gusht 2024 krahasuar me muajin gusht 2023. "Të dhënat nga Tregtia e Jashtme të Mallrave në Kosovë tregojnë për një deficit tregtar prej 9.4% në muajin gusht 2024, në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2023, gjegjësisht në vlerë prej 498,5 milionë eurosh krahasuar me deficitin prej 455,8 milionë eurosh në vitin 2023", thuhet në raportin e ASK-së. Ndërsa eksporti mbulon importin me vetëm 14,4%. Eksporti i mallrave në muajin gusht 2024 kishte vlerën 83,5 milionë euro, ndërsa importi 582 milionë euro, që është një rritje prej 24% për eksport, si dhe një rritje prej 11,2% për import,

duke krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2023. Sipas të dhënave të grupeve kryesore të eksportit: 19,6% e përbëjnë metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 19,2% e përbëjnë produktet minerale; 11,4% e përbëjnë ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 11% e përbëjnë plastika, goma dhe artikujt prej tyre; 10,3% e përbëjnë artikuj të ndryshëm të prodhuar etj. Ndërsa sipas të dhënave të grupeve kryesore për import: 15,9% e përbëjnë produktet minerale; 14,2% e përbëjnë ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 11,4% e përbëjnë makineritë, pajisjet mekanike dhe elektrike; 10,4% e përbëjnë metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 9,9% e përbëjnë mjetet e transportit etj. Eksportet e Kosovës me vendet e tjera të botës arritën në 15,8 milionë euro, ose 18,9%. Si partnerë më



të rëndësishëm nga këto vende për eksport ishin: Zvicra (10,1%) dhe ShBA (2,2%).

Importet e Kosovës me vendet e tjera të botës arritën në 264.6 milionë euro, ose 45,5%. Vendet

me pjesëmarrje më të lartë për import në këtë grup ishin: Turqia (15,1%) dhe Kina (12,9%).

Kosova merr pjesë në Forumin Ekonomik të Ballkanit Perëndimor në Berlin

PRISHTINË, 24 SHTATOR - Ministri Federal i Ekonomisë dhe Veprimit Klimatik në Gjermani, Robert Habeck, ka hapur të martën në Berlin Forumin Ekonomik të përbashkët me gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor (WB-6): Shqipëria, Bosnjë- Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia. Ky forum organizohet me rastin e takimit të ministrave të ekonomisë në kuadër të Procesit të Berlinit dhe mbështetet nga Komiteti Lindor i Ekonomisë Gjermane dhe Ministria Federale e Ekonomisë



dhe Veprimit Klimatik të Gjermanisë (BMWK). Bashkëpunimi rajonal dhe integrimi janë parakushte thelbësore për zhvillimin ekonomik të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe çelësi për anëtarësimin në BE. Në këtë Forum po merr pjesë edhe një delegacion nga Kosova, i udhëhequr nga drejtoresha ekzekutive e Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare (OEGJK), Nora Hasani. Delegacioni përbëhet nga 11 kompani të Kosovës dhe përfaqësues nga GIZ, Balkan Green Foundation

dhe Fondi i Kosovës për Efiçencë të Energjisë (Kosovo Energy Efficiency Fund). Pjesëmarrja e Kosovës në këtë forum synon ta rrisë bashkëpunimin ekonomik rajonal dhe të promovojë zhvillimin e qëndrueshëm dhe investimet në energjinë e gjelbër. Forumi Ekonomik është një mundësi e shkëlqyer për t'i thelluar marrëdhëniet ndërmjet Gjermanisë dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor, duke krijuar rrugë për bashkëpunim të mëtejshëm ekonomik dhe integrim drejt Bashkimit Evropian.

Shtyhet për mbledhjen tjetër shqyrtimi i raportit vjetor të KPMM-së për vitin 2023

PRISHTINË, 24 SHTATOR - Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti, udhëhequr nga kryetari Ferat Shala, në mbledhjen e mbajtur të martën ka miratuar draftin e planit të punës së Komisionit për sesionin

vjeshtor për vitin 2024. Ndërkaq shqyrtimi i raportit vjetor të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) për vitin 2023, me pajtim mes anëtarëve të komisionit dhe përfaqësuesve të bordit të KPMM-së, u vendos që të

bëhet në mbledhjen e radhës. Për më tepër, anëtarët e komisionit kërkuan nga bordi që, krahas raportimit për vitin 2023, të raportojnë për vitin 2022 si dhe gjashtëmujorin e parë të vitit 2024.



Krimi: 'Trekëndëshi i artë': Drogë, lumenj parash, mashtrime



Lajmërimet të çuditshme në mediat sociale, lumenj parash, mashtrime, dërgesa droge, vrasje dhe shumë më tepër. Mirë se vini në Trekëndëshin e Artë të Azisë, një vrimë e zezë e vendosur midis Mianmarit, Laosit dhe Tajlandës, disa hapa larg nga zemra e rajonit më dinamik në botë.

Që në vitet 1990 ky vend njihet si një vatër e madhe e kriminimit global. Në atë periudhë, në fakt, 80% e të gjithë heroinës së shitur në rrugët e Nju Jorkut vinte nga këtu. Megjithatë, zona së shpejti do të bëhet burimi më i madh në botë i metamfetaminës. Është

ende sot, duke gjykuar nga raporti i hartuar nga Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNODC) në qershor 2023. Dokumenti flet qartë: në vitin 2022, 151 ton pilula metamfetamine u kapën në Trekëndësh, 144 milionë prej të cilave vetëm në Laos (+800% krahasuar me 2021).

Tregtia e kombinuar e heroinës dhe metamfetaminës vlerësohet të ketë vlerën tronditëse 60 miliardë dollarë, me një kapacitet prodhues vendas që gjykohej të jetë pothuajse i pafund. Por kujdes megjithatë, sepse Trekëndëshi i Artë po

shkëlqen sërish. Përveç trafikut të drogës, janë shfaqur edhe biznese të tjera fitimprurëse.

Jo vetëm drogë: hapësirë për mashtrimet kibernetike

Falë telekomunikacioneve moderne – dmth aksesit në internet dhe rrjetet sociale – Trekëndëshi i Artë është shndërruar në një "pikë të nxehtë të kriminimit kibernetik në botë", shkruan Time. Në territoret e largëta, ushtritë e

dog-pusher – të njohur si mashtruesit e nivelit të ulët – planifikojnë mashtrime globale, mashtrime me kriptomoneda, pastrojnë para dhe kryejnë operacione të lidhura me lojërat e fatit.

Gjatë katër viteve të fundit, mendohet se kanë gjeneruar rreth 75 miliardë dollarë. Në vitin 2022 FBI kishte ngritur alarmin në lidhje me mashtrimet kibernetike në internet, që u kushtuan qytetarëve amerikanë deri në 2.6 miliardë dollarë dhe kryesisht me origjinë nga Trekëndëshi i Artë. Baronët e kriminimit kibernetik joshin punëtorët nga e gjithë bota duke postuar reklama të rreme pune. Kushdo që bie në grackën e tyre përfundon në një nga qendrat e shumta të ngritura për të kryer mashtrime virtuale...

Trekëndëshi i Artë "special"

Në mes të askundit, midis Laosit, Myanmarit dhe Tajlandës, shtrihet e ashtuquajtura Zona Ekonomike Speciale e Trekëndëshit të Artë (GTSEZ). Është zyrtarisht një zonë e veçantë ekonomike e zhvilluar nga një biznesmen kinez i quajtur Zhao Wei, e përbërë nga pallate, kazino dhe struktura të tjera. Sipas Departamentit të Thesarit

të SHBA, GTSEZ është një enklavë e vetëqeverisur që pret aktivitete kriminale të të gjitha llojeve.

UNODC-ja e lartpërmendur pretendon se është një urë që lidh grupe të ndryshme kriminale aziatike, duke i lejuar të përdorin kriptovalutat, kazinotë klandestine dhe bankat në hije për të lëvizur fitimet e paligjshme.

"Është një sipërmarrje kriminale multifunksionale. Modeli i tyre i biznesit është i thjeshtë. Siguron infrastrukturën për grupet kriminale, në mënyrë që ata të mund të hyjnë, të marrin me qira ambientet që u nevojiten, të punësojnë njerëz të armatosur dhe të marrin gjithçka që duan," shpjegon Richard Horsey, një konsulent i lartë në Grupin Ndërkombëtar të Krizave, i cili e ka studiuar zonën për një kohë të gjatë.

Nga ana e tij, Zhao pretendon se trafiku i drogës është i ndaluar në të gjithë zonën dhe se ai dhe bashkëpunëtorët e tij "absolutisht nuk lejojnë mashtrimet". Sipas mendimit të tij, zërat për përfshirjen e tij në aktivitete kriminale burojnë nga lajmet e përhapura nga Shtetet e Bashkuara në një përpjekje për të kontrolluar dhe dëmtuar Kinën. Ndërkohë, Trekëndëshi i Artë shkëlqen si kurrë më parë. / insideover – bota.al

Sekreti i vendit më të lumtur në botë

Finlanda sapo është shpallur vendi më i lumtur në botë nga Raporti i Lumturisë Botërore, i lançuar në vitin 2012 për të promovuar qëllimet e zhvillimit të qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara (OKB). Të pyeturve iu kërkua të vlerësonin jetën e tyre në një shkallë nga një deri në dhjetë.

Ndërsa vendet skandinave si zakonisht zinin vendet e para, si Amerika ashtu edhe Gjermania ranë nga 20 vendet e para. Afganistani i goditur nga lufta dhe revolucionet mbante vendin e fundit në renditjen e 143 vendeve, me një rezultat prej vetëm 1.7 krahasuar me Finlandën 7.7 dhe Danimarkën 7.6.

Barazia gjinore, besimi në institucionet kombëtare dhe bashkatdhetarët dhe korrupsioni i ulët janë të gjithë faktorë të rëndësishëm në lumturinë e finlandezëve, thotë Kai Sauer, ambasadori i Finlandës në Gjermani. Në vitin 1906 Finlanda u bë vendi i parë në botë që u dha grave të drejtën e plotë për të votuar dhe për të kandiduar në zgjedhjet parlamentare. Kur vitin e kaluar një reporter për Reader's Digest, pretendoi se humbi 12 kuleta me para dhe informacione kontakti në 16 qytete në mbarë botën për të testuar ndershmërinë e qytetarëve,

Helsinki, kryeqyteti finlandez, doli të ishte më i sinqerti: 11 nga 12 kuletat iu kthyen. Dhe sipas indeksit të fundit vjetor nga Transparency International, një organizatë me bazë në Berlin, Finlanda është vendi i dytë më pak i korruptuar në botë, pas Danimarkës.

Arsimi i shkëlqyer falas, kujdesi shëndetësor universal dhe politikat miqësore ndaj familjes luajnë një rol të rëndësishëm për t'i bërë finlandezët të kënaqur me jetën e tyre. Sistemi arsimor i Finlandës renditet i teti në mesin e vendeve më të arsimuara në botë sipas Rishikimit të Popullsisë Botërore të OKB-së.

Shërbimet shëndetësore nuk janë falas, por janë të përballueshme. Megjithatë, disa argumentojnë se arsyeja e vërtetë është se finlandezët i llogojnë mendimet e tyre negative. Finlanda ka afërsisht 3.5 milionë sauna, më shumë se një për dy finlandez. Të gjitha ndërtesat qeveritare kanë sauna. Një ekspozitë në Berlin e quajtur "Die Sauna. Echt heiss. Echt finnisch", sponsorizuar nga ambasada finlandeze, po feston kulturën e saunës me foto, video dhe ... një sauna. Është një sukses i madh. Të gjitha seancat e mbetura janë të rezervuara.

| The economist – bota.al





Pas një superkarriere 22-vjeçare pensionohet Enis Zabergja

“Epoka e re”

PRISHTINË, 24 SHTATOR - Një prej futbollistëve më të mirë në futbollin e Kosovës, Enis Zabergja, është pensionuar edhe zyrtarisht. Ai lajmin e ka me dije nëpërmjet një postimi në “Facebook”, duke u shprehur krenarë me karrierën që ka pasur, derisa ka falënderuar të gjithë ata që e kanë përkrahur dhe bashkuar gjatë rrugëtimit 22-vjeçar. Sulmuesi Zabergja ka qenë thujtë në të shumtën e rasteve i pandalshëm nga lojtarët kundërshtarë, derisa ka fituar gjithçka çka fitohet në futbollin vendor. Për një kohë ishte edhe pjesë e Përfaqësueses së Kosovës. “Çdo fillim e ka edhe fundin. Nuk është e lehtë pas 22 viteve karriere t’i thuash lamtumirë sportit më të bukur në botë. Ishte kënaqësi që punova me trajnerët me të mirë të Kosovës dhe pata kënaqësinë që luajta me lojtarët më të mirë të Kosovës. Fitova gjithçka çka fitohet në futbollin e Kosovës! Shënova mbi 250 gola dhe krenaria me e madhe ishte të luaja për Kombëtaren e Kosovës. Gazetarë, futbollistë, tifozë ishte kënaqësi që këto vite ishim bashkë, ishim bashkë në kohë të mira dhe në kohë të



vështira, por ia vlejti tani na njej e gjithë bota dhe djemtë tanë po luajnë në çdo vend të botës. Edhe njëherë faleminderit nga të gjithë! E në fund faleminderit familja ime që me përkrahet çdo minutë!

Ky është futbollin, i vjen koha dhe gjithçka përfundon”, ka shkruar Zabergja, i cili ka luajtur për Hysin, Trepçën, Hajvalinë, Mitrovicën, Llapin, KEK-un, Shkëndijën e Tetovës dhe Prishtina e Re.

Superkupa mbahet në Pejë

Pejë, 23 shtator - Superkupa e Kosovës në konkurrencën e femrave do të mbahet këtë vit në qytetin e Pejës, ku do të zhvillohen ndeshje të jashtëzakonshme që nga çerekfinalet deri në finale. Pas përfundimit të konkursit dhe bazuar në kompetencat që dalin nga Statuti dhe Rregullorja e Punës së Bordit të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), Bordi ka vendosur që Superkupa Femrat të organizohet nga 30 shtator deri më 4 tetor 2024. Ngjarja do të organizohet nga KBF Peja 03 në bashkëpunim me FBK-në. Gjatë këtyre ditëve të Superkupës, skuadrat e Superligës do ta kenë mundësinë t’i kryejnë testet



finale para fillimit të kampionatit 2024/25. Në edicionin e kaluar triumfues i Superkupës ishte Bashkimi,

i cili fitoi edhe Kupën dhe titullin, duke siguruar tre trofetë në basketbollin e femrave.

SHKURT

Çeku: Gjakova dhe Kosova do të kenë një stadium të nivelit ndërkombëtar

Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku, ka thënë se me dinamikë të lartë po zhvillohen punimet në stadiumin e Gjakovës. Sipas tij, Gjakova dhe Kosova do të kenë një stadium të nivelit ndërkombëtar, i cili do të ofrojë kushte moderne për futbollistët dhe sportdashësit. “Me dinamikë të lartë po zhvillohen punimet në stadiumin e Gjakovës. Gjakova dhe Kosova do të kenë një stadium të nivelit ndërkombëtar, i cili do të ofrojë kushte moderne për futbollistët dhe sportdashësit. Kemi ndarë nëntë milionë euro për ta përfunduar stadiumin, në bashkëpunim me komunën e Gjakovës. Investimet në infrastrukturë sportive po vazhdojnë dhe nuk do të ndalen, si për nevoja të brendshme, po ashtu edhe në përgatitje për Lojërat Mesdhetare ‘Prishtina 2030’”, ka shkruar Çeku në “Facebook”.

Rashica në formacionin e javës në Turqi

Milot Rashica ka hyrë në formacionin e javës në Superligën e Turqisë. Futbollisti nga Kosova pati paraqitje mjaft të mirë duke shënuar gol në fitoren 2:1 të Besiktasit ndaj Eyupspor në fundjavë. Nga Sofascore, Milot Rashica u vlerësua me notën 8.4, më të lartën nga futbollistët që bëjnë pjesë në këtë 11-she dhe të njëjtë me portierin e Galatasarayt, Fernando Muslera. Është kjo hera e dytë që ylli nga Kosova zë vend në formacionin e javës në elitën e futbollit turk. Formacioni: Muslera, Yavru, Stka, Heliton, Sen, Charisis, Rashica, Cham Saraqeviq, Hwang, Janvier, Dzeko.

KH Besa shijon fitoren e parë

KH Besa Famgas e ka shënuar fitoren e parë në edicionin e ri të Superligës së Kosovës në hendboll. Besa fitoi në kryeqytet ndaj Prishtinës me rezultat 37:30. Ndeshja i takoi xhiros së dytë të kampionatit të Kosovës. Në xhiron e parë, Besa humbi derbin me Rahovecin, kurse Prishtina kishte fituar ndaj Llapit. Prishtina nisi mirë ndeshjen dhe krijoi epërsi prej 6:2. Mbajti epërsi për kohë të gjatë. Besa ia doli të barazojë në pesë minutat e fundit të pjesës së parë. Lojë e barabartë u zhvillua deri në minutën e 40 e më pas nisi shkëputja e skuadrës pejane. Besa vetëm në minutat e fundit bëri shkëputje më të madhe në rezultat. Jon Vokshi i realizoi 10 gola për Besën, kurse shtatë i kishte Vladimir Stankoviq. Te Prishtina u dallua Albi Gjuka me 14 gola. Gjashtë i kishte Oltion Beshiri.

Ismajli zgjidhet në formacionin e javës në Serinë A

Ardian Ismajli po zhvillon një sezon fantastik me Empolin. Mbrojtësi i Kombëtares është zgjedhur mes 11 më të mirëve të raundit të pestë në Serinë A teksa, sipas “Who Scored”, ka notën më të lartë. 8.31 për Ismajlin që lë pas shumë yje, mes tyre edhe Gabbian që i dha tri pikë Milanit në derbin kundër Interit. Krah Ismajlit është shoku i skuadrës Viti, teksa Dodo dhe Dimarco plotësojnë linjën e prapavijës. Fitorja 0-2 e Empolit në udhëtim kundër Cagliariarit dhe paraqitja e shkëlqyer e Ismajlit e bëjnë mbrojtësin kuqezi të preferuar. Me formën aktuale ai duket se po bën shumë fansa dhe vështirë se nga sezoni i ri do të jetë më pjesë e Empolit. Formacioni: Falcone, Dodo, Ismajli, Viti, Dimarco, Busio, Reijnders, Dybala, Gudmundsson, Esposito, Zapata.

Norris: Gjatë garës më dukej sikur fluturoja, rrezikova, por kështu fitohet titulli

LONDËR, 24 SHTATOR - Fitorja e Lando Norris në Çmimin e Madh të Singaporit i dha mundësi pilotit britanik të McLarenit që ta ngushtojë diferencën në klasifikimin e përgjithshëm ndaj holandezit të Red Bullit, Max Verstappen.

Tashmë kampioni i botës udhëheq 52 pikë. Pavarësisht se e fitoi garën me 27 sekonda avantazh, nuk munguan rreziqet për britanikun, dy herë kaloi shumë pranë barrierave. Madje ai pati edhe një kontakt të lehtë, por pa pësuar dëmtime

që do të komprometonin garën e tij. "Ishte një garë fantastike. Kam marrë disa rreziqe nga mesi i garës, por mendoj se e kam kontrolluar mjaft mirë makinën. Njëvendëshja që po pilotoja ishte e jashtëzakonshme, dukej sikur

fluturoja në pistë", ka thënë Lando Norris, që korri suksesin e tretë në Formula 1. "Ne fluturoam gjatë gjithë garës. Ishte e vështirë, por më pëlqeu ajo që arritëm në Singapor. E rëndësishme është që nuk kam pasur



dëmtime të tepërta nga fakti që po pilotoja në maksimum, por pa rrezikuar nuk fitohet", ka shtuar britaniku.

Kroos: UEFA-s iu deshën tre muaj për ta kuptuar se ishte penallti

BERLIN, 24 SHTATOR - Mesfushori Toni Kroos ndihet ende i zemëruar me vendimin e gjyqtarëve për mosakordimin e një penalltie të dukshme në humbjen e tyre në çerekfinale të "Euro 2024" në vazhdimet ndaj Spanjës. Së fundmi UEFA doli me udhëzime të reja për prekjet e topit me duar pas "Euro 2024". "Çdo kontakt me top që ndalon një goditje në portë duhet të ndëshkohet më rreptësisht dhe në shumicën e rasteve duhet të jepet një goditje dënimi, përveç rastit kur krahu i mbrojtësit është shumë afër trupit ose në trup", thotë rregulli.

UEFA sqaroi se në rastin e Marc Cucurella në çerekfinalen e "Euro 2024", gjyqtari bëri një gabim që nuk akordoi penallti ndaj Spanjës. "Në atë rast mbrojtësi ndalon goditjen në portë me krahu e tij, i cili nuk është shumë afër trupit, kështu që duhet të ishte dhënë një goditje dënimi.



Nuk kërkohet asnjë masë disiplinore", shtuan ata.

Kroos u pyet nga gazetarët se çfarë mendon për qëndrimin e ri të UEFA-s për rregullat e prekjës së topit me dorë dhe përgjigja e tij ishte klasike. "Atyre iu deshën tre muaj për të kuptuar se ishte një lojë me dorë, diçka që pothuajse të gjithë ne e pamë në një sekondë. Faleminderit, nuk ishte aq e rëndësishme!", u

përgjigj me ironi Kroos. "A do të jem në gjendje të bëhem kampion i Evropës tani që zyrtarisht kanë thënë se ishte një gabim? Nuk e di", ka shtuar mesfushori i pensionuar. Incidenti i "dorës së Cucurellas" ndodhi në minutën e 107 të lojës dhe do ta ndihmonte Gjermaninë dhe Kroosin të arrinin në gjysmëfinale dhe ndoshta në finale të "Euro 2024".

Dubois, Usyut: E pres për revansh dhe për t'i unifikuar titujt kampionë bote

LONDËR, 24 SHTATOR - Boksieri britanik Daniel Dubois, që dy ditë më parë u shpall kampion bote në peshën e rëndë, kategoria IBF, ka konfirmuar se ka plane të mëdha për të ardhmen. Ai kërkon të hakmerret ndaj Oleksandr Usyk, ndaj të cilit ka humbur në përballjen e një viti më parë. Dubois, në stadiumin "Wembley" të Londrës, fitoi titullin vakant të IBF-së, pas fitores me Ko në raundin e pestë ndaj Anthony Joshuas. Në këtë sfidë kampioni i ri i botës tregoi një formë të jashtëzakonshme, duke befasuar në ring. Ai mendon se humbja ndaj Usyut një vit më parë (gusht 2023 në Poloni) ishte e padrejtë, pasi gjyqtarët ndikuan në momentin që ai e hodhi në tapet ukrainasin, duke e konsideruar goditjen si faull (nën brez). Më pas ai u mund me KO në raundin e nëntë. "Jam gati për revanshin



edhe pse ajo sfidë pati një vendim jo të drejtë. Unë kam një titull, Usyk ka të tjerët ndaj mund të organizojmë një duel për t'i unifikuar ato. Jam gati për këtë duel nëse ukrainasi pranon", ka thënë Dubois. Gjithsesi, kjo sfidë

nuk do të jetë e lehtë për t'u organizuar, pasi Usyk do të përballlet në dhjetor me Tyson Fury. "Unë do të pres, por mendoj se kjo sfidë mes nesh ka më shumë sens. Të shohim se si do të rrjedhin ngjarjet", ka shtuar Dubois.

SHKURT

Bahri Gjinovci, kandidat i vetëm për postin e kryetarit të FVK-së

Bahri Gjinovci është i vetmi kandidat i propozuar për postin e kryetarit të Federatës së Volejbollit të Kosovës. "Sipas afatit të caktuar dhe në bazë të Nenit 26 të Statutit të FVK-së, i vetmi kandidat i propozuar për kryetar të FVK-së është Bahri Gjinovci. Gjinovci që u zgjodh në vitin 2021 është në përmblyje të mandatit të parë, pas të cilit ka marrë pëlqimin e shumicës së delegatëve, që ta vazhdojë edhe një mandat tjetër, në krye të shtëpisë së volejbollit të Kosovës", thuhet në njoftimin e FVK-së. Sipas njoftimit, Kuvendi i Punës dhe ai Zgjedhor i FVK-së, do të mbahet më 27 shtator nga ora 17:30, në Holiday Resort (Sllatinë e Madhe).

Uzuni në formacionin e javës në La Liga 2

Sulmuesi i kombëtares shqiptare të futbollit, Myrto Uzuni, vazhdon ecurinë pozitive me skuadrën e Granadas. Në këtë nisje sezoni në La Liga 2, sulmuesi "kuqezi" ka gjetur dy herë rrugën drejt rrjetës. Ai shënoi në barazimin ndaj Elches në javën e pestë të kampionatit si dhe në ndeshjen e javës së gjashtë ndaj Malagas, me të dyja takimet që u mbyllën me rezultatin 2-2. Forma e mirë që po kalon ka bërë që Myrto Uzuni të përfshihet në formacionin e javës në La Liga 2.

Nadali përfshihet në ekipin e Spanjës për Davis Cup

Rafael Nadal është përfshirë në skuadrën e Spanjës për Finalet e Davis Cup në nëntor. Ish-numri një i botës, 38 vjeç, është shtuar përkrah numrit tre të botës, Carlos Alcaraz, Roberto Bautista Agut, Pablo Carreno Busta dhe Marcel Granollers. Nadali nuk ka garuar që nga Lojërat Olimpikë Paris 2024, ku kampioni 22 herë i Grand Slamit u mposht në ndeshjen teke nga Novak Djoković dhe humbi në çerekfinale të dysheve pas bashkëpunimit me Alcaraz. Ai u tërhoq nga US Open në gusht dhe nga Kupa Laver javën e kaluar për shkak të shqetësimeve për gjendjen fizike.

'Marca' zbulon fituesin e 'Topit të Artë'

Thuajse një muaj na ndan nga shpallja e fituesit të "Topit të Artë 2024" që do të jepet në Paris më 28 tetor, gara vazhdon të jetë e ngushtë mes disa lojtarëve, konkretisht mes Vinicius Jr. dhe Rodrit. Por duket se prestigjiozja spanjolle "Marca" nuk ka dyshime sa i përket lojtarit më të mirë në botë për këtë vit, titull i cili, sipas saj, do t'i shkojë sulmuesit të "Los Blancos". Pasi Luka Modriq dhe Karim Benzemas që thyen dominimin e Cristiano Ronaldos dhe Lionel Messit si dy lojtarët e vetëm që fituan "Topin e Artë" që nga viti 2008, do të jetë sërish një lojtar i Real Madridit, këtë herë brazilian, ai që do të fitojë më të rëndësishmin individual në futboll. Sipas "Marca"-s, Vinicius Junior e ka mposhtur konkurrencën e bashkëlojtarëve të Real Madridit, Kylian Mbappe, Jude Bellingham dhe Dani Carvajal, mesfushorin e Manchester Cityt, Rodri si dhe sulmuesin e Interit, Lautaro Martinez. Sezoni e kaluar, Vinicius shënoi 24 gola dhe dha 11 asistime në 39 ndeshje për Realin, duke fituar La Ligën, Ligën e Kampioneve, Superkupën Evropiane dhe Superkupën e Spanjës.

Nagelsmann: Lëndimi i Ter Stegen është tronditje e madhe për ne

Trajneri i Gjermanisë, Julian Nagelsmann, ka thënë se lajmi për lëndimin e rëndë të gjurit të Marc-Andre ter Stegen ishte një tronditje e madhe pasi portieri i Barcelonës iu nënshtrua një operacioni që pritet ta lërë jashtë

për të paktën tetë muaj. Ter Stegen pësoi një këputje të tendinës së patelës në gjurin e djathtë, ka njoftuar Barcelona. Portieri u rrëzua keq pasi u hodh për të kapur një top gjatë fitores 5-1 të Barcelonës ndaj Villarrealit

në La Liga të dielën dhe u duk qartë në dhimbje teksa u largua nga fusha me barelë. Pësha e tij ra mbi gjurin e djathtë, në të cilin ai kishte kryer dy operacione në sezonet 2019/20 dhe 2020/21. "Lajmi për lëndimin e Marcit

ishte një tronditje e madhe për ne", ka thënë Nagelsmann, i cili tani ka humbur dy portierë me përvojë brenda një muaji pas tërheqjes së Manuel Neuer nga futbolla ndërkombëtar në gusht. "Do të na mungojë shumë si në

fushë, ashtu edhe jashtë saj. Ne i urojmë Marcit gjithë të mirat... gjithmonë do të jemi aty për të gjatë rrugës së tij të rikthimit", ka deklaruar Nagelsmann për faqen e internetit të Federatës Gjermane të Futbollit (DFB).



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Candy Wenderland” Sh.P.K. me seli në Vushtrri, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. UNIK: 812169002 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Candy Wenderland” D.O.O. od Vushtrria, donelo odluku o prestani rada sa nr. 812169002 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Candy Wenderland” L.L.C. with headquarters Vushtrria, has come to the decision to quit its business: 812169002 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Burim Tanaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu “ Vëllezërit Frashëri “ Planej.

- Bajram Tanaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu “ Vëllezërit Frashëri “ Planej.

- Melisa Berisha shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu “ Gani Saramati “ Prizren.

- Destan Cabrati shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu “ Vëllezërit Frashëri “ Planej.

- Emine Kuleta shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme Teknike “28 Nëntori” Prishtinë.

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër “Bill Clintonit”, kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra “Qerimi2”, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Llullat, Rr. Bajram Kelmendi



SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Titulli i vendit të punës: Udhëheqës/e
Grada e pozitës: 3.a.a
Kohëzgjatja e punësimit: Me afat të pacaktuar
Njësia: Njësia e Auditimit të Pajtueshmërisë (NJAP)
Raporton tek: Shefi/ja i/e Auditimit të Brendshëm

Qëllimi dhe fushëveprimi i pozitës:

Udhëheqësi/ja i/e kësaj njësie udhëheq dhe mbikëqyr Njësinë e Auditimit të Pajtueshmërisë, si dhe në përgjithësi do të jetë përgjegjës për çështjet që kanë të bëjnë me këtë njësi. Ai/Ajo punon nën mbikëqyrje të drejtpërdrejtë të Shefit/es të/së Auditimit të Brendshëm.

Fushëveprimi i punës për këtë pozitë është si në vijim:

- Auditimet e Brendshme;
- Sistemet dhe procedurat dhe çështjet tjera administrative;
- Trajnimi dhe zhvillimi.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Auditimet e brendshme:

- Së bashku me Udhëheqësin/en e Njësies së Auditimit të Teknologjisë Informative, përgatisin Planin Strategjik të Auditimit të Brendshëm nën mbikëqyrjen dhe miratimin e Shefit/es të/së Auditimit të Brendshëm;
- Së bashku me Udhëheqësin/en e Njësies së Auditimit të Teknologjisë Informative, përgatisin Planin Vjetor të Auditimit të Brendshëm bazuar në "Qasjen në Rrezik" nën mbikëqyrjen dhe miratimin e Shefit/es të/së Auditimit të Brendshëm;
- Komunikon rezultatet e angazhimeve të auditimit dhe detyrave të kështillimit për Menaxhmentin, përmes Shefit/es të/së Auditimit të Brendshëm;
- Finalizon draft-raportet e përgatitura nga auditorët e kësaj njësie, për miratim nga Shefi/ja i/e Auditimit të Brendshëm dhe i dërgon tek Menaxhmenti për komente eventuale;
- Mban takime përmbyllëse me drejtorët e departamenteve dhe Menaxhmentin për diskutimin e gjetjeve dhe rekomandimeve, si dhe planin e veprimit të Menaxhmentit;
- Përgatit përcjelljen e implementimit të rekomandimeve për raportim tek Shefi/ja i/e Auditimit të Brendshëm;
- Në koordinim me Shefin/en e Auditimit të Brendshëm cakton ekipin e auditimit nëpër auditime të rregullta.
- Në koordinim me Shefin/en e Auditimit të Brendshëm cakton ekipet e auditimit në auditimet/angazhimet tjera të përcaktuara në Statutin e Auditimit të Brendshëm.

Sistemet/procedurat dhe çështjet administrative:

- Gjatë ushtrimit të detyrave, kujdeset që personalisht dhe auditorët e kësaj njësie janë duke iu përmbajtur Ligjit të BQK-së, Statutit të Auditimit të Brendshëm, Manualit të Auditimit të Brendshëm, Kodit të Etikës, si dhe rregullave tjera të brendshme të BQK-së;
- Bashkë me auditorët, mund të merr pjesë në takime që kanë karakter vëzhgues apo këshilldhënës gjatë implementimit të programeve të ndryshme;
- Në koordinim me Shefin/en e Auditimit të Brendshëm dhe bashkërisht me Udhëheqësin/en Njësies së Auditimit të Teknologjisë Informative cakton objektivat afatgjata të Auditimit të Brendshëm;
- Në koordinim me Shefin/en e Auditimit të Brendshëm, përgatit propozimet e planit të trajnimeve dhe buxhetit vjetor për Njësinë e Auditimit të Pajtueshmërisë;
- Kryen detyra të tjera që mund t'i caktohen nga Shefi/ja i/e Auditimit të Brendshëm, duke përfshirë këtu edhe angazhimin në auditime.

Trajnimi dhe zhvillimi:

- Të ketë gatishmëri për të marrë pjesë në trajnime relevante për auditime të brendshme, si dhe të ofroj ndihmën e duhur për pjesën tjetër të personelit në Njësinë e Auditimit të Pajtueshmërisë;
- Të dëshmojë se ai/ajo është duke i zhvilluar aftësitë e tij/sajë në dobi të Bankës Qendrore të Kosovës dhe Auditimit të Brendshëm, brenda sajë.

Përgatitjet profesionale/kualifikimet:

- Diplomë universitare në fushën e ekonomisë, biznesit, menaxhmentit, apo juridike;
- Së paku shtatë (7) vite përvojë pune profesionale në auditim, prej tyre së paku tri (3) vite në auditim të brendshëm;
- Tri (3) vite përvojë menaxheriale ose përvojë në udhëheqjen e ekipeve të auditimit;
- Certifikatë profesionale në auditim të brendshëm apo të jashtëm të sektorit publik/privat;
- Të ketë njohuri shumë të mira mbi Standardet Globale të Auditimit të Brendshëm;
- Aftësi të larta të planifikimit, organizative dhe drejtuese;
- Aftësi për t'iu përshatur prioritetet dhe kërkesave, afateve kohore përmes aftësive të nivelit të lartë analitik dhe zgjidhjes së problemeve;
- Aftësi komunikimi dhe bashkëpunimi, përfshirë aftësinë për të krijuar dhe mbajtur marrëdhënie mirëbesimi me praporin dhe personelin që e menaxhon;
- Aftësi për të motivuar personelin dhe për të menaxhuar me sukses punët e njësies;
- Saktësi, vëmendje në detaje, si dhe ndjeshmëri ndaj prioritetet;
- Të ketë njohuri të shkëlqyeshme të përdorimit të aplikacioneve softuerike të pakos MS Office;
- Të ketë njohuri të rrjedhshme të gjuhës shqipe dhe/ose serbe në të folur dhe të shkruar;
- Njohja shumë e mirë e gjuhës angleze paraqet përparësi;
- Të ketë aftësi për të punuar në mënyrë efektive në një ambient multi-etnik dhe multi-kulturor.

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi dhe përshatshmëria për këtë pozitë;
- Dëshmi mbi përvojën e punës**, (kopjet e kontratave ose vërtetimeve nga punëdhënësi ose dokumente tjera relevante që shërbejnë për të dëshmuar pozitën e mbajtur dhe përvojën e punës, pa cenar aktet relevante për mbrojtjen e të dhënave personale);
- Raportin nga Fondi për Kursime Pensionale i Kosovës (Trusti)** për periudhën përkatëse, apo vërtetimin tatimor nga Administrata e Tatimore (ATK) kur raporti nga Trusti nuk aplikohet ligjërisht;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuar zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Kopjen e certifikatës profesionale;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **09 tetor 2024**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Format tjera të aplikimit nuk do të merren parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : www.bqk-kos.org



OGLAS ZA SLOBODNO RADNO MESTO

Naziv radnog mesta: Rukovodilac/lja
Rang pozicije: 3. a. a
Trajanje zaposlenja: Na neodređeno vreme
Jedinica: Jedinica za reviziju usklađenosti (JRU)
Izveštava: Šefu unutrašnje revizije

Svrha i delokrug pozicije:

Rukovodilac/lja ove jedinice vodi i nadzire Jedinicu za reviziju usklađenosti, te će uopšte biti odgovoran/na za pitanja koja se odnose na ovu jedinicu. On/ona radi pod direktnim nadzorom šefa/ice unutrašnje revizije.

Delokrug posla za ovu poziciju je sledeći:

- Unutrašnje revizije;
- Sistemi i procedure i druga administrativna pitanja;
- Obuka i razvoj.

Dužnosti i odgovornosti:

Unutrašnje revizije:

- Zajedno sa rukovodiocem/ljem Jedinice za reviziju informacionih tehnologija pripremaju Strateški plan unutrašnje revizije pod nadzorom i odobrenjem šefa/ice unutrašnje revizije;
- Zajedno sa rukovodiocem/ljem Jedinice za reviziju informacionih tehnologija pripremaju Godišnji plan unutrašnje revizije na osnovu „Pristupa rizika“ pod nadzorom i odobrenjem šefa/ice unutrašnje revizije;
- Saopštava rezultate revizorskih angažmana i savetodavnih zadataka, preko šefa/ice unutrašnje revizije;
- Finalizira nacrt izveštaja pripremljenih od strane revizora ove jedinice, na odobrenje od strane šefa/ice unutrašnje revizije i šalje ih Rukovodstvu za eventualne komentare;
- Održava završne sastanke sa direktorima odeljenja i Rukovodstvom radi razmatranja nalaza i preporuka, kao i akcionog plana Rukovodstva;
- Priprema praćenje sprovođenja preporuka za izveštavanje šefu/ici unutrašnje revizije;
- U koordinaciji sa šefom/icom unutrašnje revizije, imenuje revizorski tim za redovne revizije.
- U koordinaciji sa šefom/icom unutrašnje revizije, raspoređuje revizorske timove za revizije /druge angažmane definisane Statutom unutrašnje revizije.

Sistemi/procedure i administrativna pitanja:

- Tokom obavljanja dužnosti, vodi računa da se lično i revizori ove jedinice pridržavaju Zakona CBK-a, Statuta unutrašnje revizije, Priručnika unutrašnje revizije, Etičkog kodeksa, kao i drugih unutrašnjih pravila CBK-a;
- Zajedno sa revizorima može učestvovati na sastancima koji imaju posmatrački ili savetodavni karakter tokom realizacije različitih programa;
- U koordinaciji sa šefom/icom unutrašnje revizije i zajedno sa rukovodiocem Jedinice za reviziju informacionih tehnologija, postavlja dugoročne ciljeve unutrašnje revizije;
- U koordinaciji sa šefom/icom unutrašnje revizije, priprema predloge plana obuke i godišnjeg budžeta za Jedinicu za reviziju usklađenosti;
- Obavlja i druge poslove koje može poveriti šef/ica unutrašnje revizije, uključujući angažovanje u reviziji.

Obuka i razvoj:

- Spremnost da učestvuje u relevantnim obukama za unutrašnje revizije, kao i da pruži odgovarajuću pomoć ostatku osoblja u Jedinici za reviziju usklađenosti;
- Da dokaže da on/ona razvija svoje sposobnosti u korist Centralne banke Kosova i unutrašnje revizije, u okviru nje.

Stručne pripreme/kvalifikacije:

- Univerzitetska diploma iz oblasti ekonomije, biznisa, menadžmenta ili prava;
- Najmanje sedam (7) godina profesionalnog radnog iskustva u reviziji, od čega najmanje tri (3) godine u unutrašnjoj reviziji;
- Tri (3) godine menadžerskog iskustva ili iskustvo u vođenju revizorskih timova;
- Profesionalni sertifikat za unutrašnju ili spoljnu reviziju javnog/privatnog sektora;
- Da poseduje veoma dobra saznanja o Globalnim standardima unutrašnje revizije;
- Visoke sposobnosti planiranja, organizacije i upravljanja;
- Sposobnost prilagođavanja prioritetima i zahtevima, rokovima kroz visok nivo analitičkih sposobnosti i veština rešavanja problema;
- Sposobnosti komunikacije i saradnje, uključujući sposobnost kreiranja i održavanja odnosa poverenja sa nadređenim i osobljem kojim rukovodi;
- Sposobnost motivisanja osoblja i uspešnog vođenja poslova jedinice;
- Preciznost, pažnja prema detaljima i osetljivost na prioritete;
- Odlučno poznavanje upotrebe softverskih aplikacija MS Office paketa;
- Tečno poznavanje albanskog i/ili srpskog jezika u govoru i pisanju;
- Vrlo dobro poznavanje engleskog jezika je prednost;
- Da ima sposobnost da efikasno radi u multietničkom i multikulturalnom okruženju.

Svi kandidati moraju dostaviti sledeću dokumentaciju:

- Službeni obrazac CBK-a za apliciranje;
- Propratno pismo (motivaciono pismo) u kojem se naglašava interesovanje i podobnost za ovu poziciju;
- Dokaz o radnom iskustvu**, (kopije ugovora ili potvrde od poslodavca ili druga relevantna dokumenta koja služe za dokazivanje obavljanja funkcije i radnog iskustva, bez kršenja relevantnih akata za zaštitu ličnih podataka);
- Izveštaj od Fonda za penzione štednje Kosova (Trusta)** za relevantni period, ili poreska potvrda od strane Poreske administracije (PAK) kada izveštaj Fonda nije zakonski primenjen;
- Kopije diploma, dok diplome stečene van Republike Kosovo moraju biti službeno priznate / nostrifikovane od strane MONT-a;
- Kopija stručnog sertifikata;
- Dokaz o identitetu/kopija lične karte koja služi za dokazivanje državljanstva Kosova.

Procedura apliciranja:

- Krajni rok za apliciranje je **09 oktobar 2024**.
- Apliciranje se može izvršiti online (<https://hris.bqk-kos.org>) preko službene internet stranice CBK-a ili preko arhive CBK-a. Ostali obrasci za apliciranje se neće razmatrati.
- Obrazac za apliciranje možete preuzeti preko službene internet stranice: www.bqk-kos.org

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992







ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

